

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ SKY TOUR “ Shpk**

Sot me date 23 Tetor 2019 (Dymije e nente mbedhjete), une ortaku i vetem :

1. **Znj. Brikela BEJKO**, e bija e Janit , e datelindjes 26.10.1973 lindur ne Fier dhe banuese ne Lagja "Komuna e Parisit ", Tirane, mbajtese e leternjoftimit **0334862658**, bazuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "

Vendosa :

- Te krijoj shoqerine me pergjegjsi te kufizuar : "**SKY TOUR “ Shpk**

**NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE**


- Shoqerine "**SKY TOUR “ Shpk** e krijoj sipas llojit Shoqeri me pergjegjsi te kufizuar duke e emertuar "**SKY TOUR “ Shpk**

**NENI 2
KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

- Shoqeria "**SKY TOUR “ Shpk** do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 10 vjet.
- Me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej.

**NENI 3
EMERTIMI DHE QENDRA (SELIA)**

- Selia e shoqerise do te jete ne Tirane Rruga " Mine Peza", pallati 37/1,përbalë Vilës "Tafaj" ", Tirane,
- Telefon : +35569 32 80 520
Email: sky.tour.al@gmail.com



NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë :

- Agjensi Udhetimi, Bileta Avioni, Bileta Trageti, Rezervime Hoteli
- Agent per kompani Sigurimi.
- Sherbime ne fushen e Turizmutsi " Udhetime Turistike Brenda dhe jashte Vendit "
- Makina me Qera

NENI 5

REGJIMI JURIDIK

- Ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, Shoqeria do te udhehiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakut te saj te percaktohet me hollesisht ne Statutin qe I bashkangjitet ketij Akti.
- Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plete ne perputhje me legjislacionin shqiptar me fuqi.
- Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e per gjithshme te kontabilitetit sic sqarohet me me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

NENI 6

KAPITALI I SHOQERISE

- Kapitali baze i Shoqerise eshte : ne Lek – **100,000** leke (Nje qind mijë) i barabarte me 1 (Nje) kuota, me nga **100,000 leke** (Nje qind mijë leke, teresisht prone e ortakut te vetem te shoqerise te cilat do te depozitohen ne banken “ Tirana bank ‘ pas regjistrimit ne QKR, si capital themeltar i shoqerise “ **SKY TOUR “ Shpk**
- Kapitali i shoqerise, zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise **Z. Brikela BEJKO** e cila zoteron **100.0%** te gjithe vleres se kapitalit, te perbere nga **1** kuote, me vlere totale prej **100,000 Leke**.
- Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike, financiare si dhe te vendimeve qe do te marre une ortaku i vetem per ta rritur ate ne te ardhmen.
- Ne rast vdekje te ortakut te vetem te shoqerise, pasuria u kalon trashegimtareve te mij sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.



- Kapitali themeltar fillestardo te ngurtesohet ne llogari bankare te shoqerise pasi te behet regjistrimi ne QKR.
- Per nevoja te punes dhe te ushqimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te cele llogari ne cdo banke te njojur me ligj, qofte kjo private ose shteterore

NENI 7 DREJTIMI I SHOQERISE

- Fillimisht shoqeria do te udhehiqet , administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqerise **Z. Brikela BEJKO** per nje periudhe 5 (Pese) vjecar me te drejte rizgjidhje, I cili do te jete drejtues ligor I saj, si dhe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.
- Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise une ortaku i vetem i saj do te vendos zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik.
- Per cdo ceshtje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj, shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkohshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi.

Kompetencat kryesore te ortakut te vetem do te jene:

- Te beje ndryshime ne aktin e themelimit
- Te beje ndryshime me objektin e veprimtarise
- Te miratoje rezultatet vjetore te Shoqerise
- Te riorganizoje ose te mbylle shoqerine
- Te miratoje projekte zgjerimi dhe materializmin e veprimtarise se Shoqerise
- Te miratoje raportin vjetor te veprimtarise se kryer nga Administrata e Shoqerise
- Te emeroje dhe te shkarkoje nga detyra personelin e shoqerise dhe tu percaktoje shperblimin qe do ju jepet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

NENI 8 DISPOZITAT EKONOMIKE

- Veprimataria ekonomike – financiare dhe tregtare e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregtar dhe juridik me persona te trete shoqeria pergiqjet me pasurite e veta.



- Aktivi dhe pasivi I veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike – financiare dhe tregtare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj.
- Pasurite e shoqerise vleresohen nepermejt bilanceve ekonomiko – financiare dhe tregtare te saj, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.
- Te ardhurat e shoqerise pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se paluajtshme dhe te luajtshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interest e shoqerise, me takojne mua ortakut te vetem te saj sipas dispozitave te percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj.
- Per detyrimet shoqeria pergjigjet me fondet e veta.
- Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese, apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Masa e pasigurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga une ortaki I vetem.

NENI 9 LLOGARIA E SHOQERISE


- Shoqeria llogarine rrjedhese te saj e ka ne disa Banka te Shqiperise. Ajo mund te cele edhe llogari te tjera rrjedhese ne bank ate ndryshme, ne euro dhe dollare Amerikane.
- Shoqeria I mban llogarite ne leke shqiptare ose ne valute te huaj, sipas rastit qe i paraqitet per veprimet te ndryshme monetare.
- Te gjitha shpenzimet e shoqerise ne leke apo ne valute, sigurohen nga arketimet e sherbimeve dhe veprimeve qe pasqyrohen ne objektin e veprimtarise se saj, osa nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi ne republiken e Shqiperise.

NENI 10 VITI EKONOMIK

- Viti ekonomik fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te atij viti.

NENI 11 DHENIA E LLOGARISE EKONOMIKE

- Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ekonomike ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, te dipozitave te aktit te themelimit dhe te Statutit te krijimit te saj, si dhe programeve te vecanta qe do te hartoj une ortaku i vetem i saj per cdo vit ekonomik.



- Llogaria ekonomike e shoqerise mbeshtetet ne llogarite e sherbimeve dhe te vefinancimeve qe mbulon shpenzimet e veta.
- Per nxitjen ekonomike te veprimtarise se shoqerise do te krijohen fonde reserve dhe fonde te tjera te vecanta ne perputhje me mundesite ekonomiko financiare dhe tregtare te saj.
- Shoqeria do te mbaje kontabilitet ne baze te rregullave, metodave teknike kontabe ne gjuhen shqiper dhe ne leke shqiptare. Per mbajtjen e kontabilitetit do te perdoren Libri Ditar, libri I Madh, Libri inventor etj.
- Cdo forme organizimi e kontabilitetit do te mbahet e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jashtem ne menyre te tille qe cdo ekspert kontabel te nxjerre nga librat kontabel nje pamje te per gjithshme te veprimeve te kryera dhe veprimtarise se shoqerise

NENI 12 **RAPORTI VJETOR**

- Raporti vjetor I veprimtarise se shoqerise do te paraqitet ne formen dhe permbajtjen e percaktuar ne ligjin NR 9901, Date 14.04.2008 ‘ per tregtaret dhe shoqerite tregtare ‘

NENI 13 **RASTET E NDRPRERJES SE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

- Une ortaku i vetem i shoqerise kam te drejten e nderprerjes se maredhenieve qe rrjedhin nga Statuti dhe Akti i Themelimit te Shoqerise kur per kete vertetohen arsyet sic mund te jene :
 1. Veprimi i kushteve te forcave madhore
 2. Varferimi i shoqerise
 3. Dalja e nje vendimi nga Organet kompetente qe ndalon veprimtarine e saj
 4. Marrja e vendimiy perkates nga une Ortaku i vetem

NENI 14 **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

- Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, ose vendoset nje politike me e favorshme nga legislacioni I pasqyruar be Aktin dhe ne Statutin e krijimit te Shoqerise, atehere une ortaku I vetem I kesaj kam te drejten tu drejtohem organeve tatimore



shteterore qe te zbatojne regjistrimin me te favorshem per mua dhe shoquerine e krijuar prej meje.

NENI 15 **ZGJISHJA E MOSMARREVESHJEVE**

- Zgjidhja e mosmarreveshjeve midis personave te ndryshem te shoquerise do te behet me mirekutpim, e nese kjo nuk arrihet atehere pala e interesuar mund ti drejtohet organeve kompetente te juridiskionit te vendit ku kane lindur mosmarrveshjet.

NENI 16 **DISPOZITA TE VECANTA**

- Te gjitha dokumentat e shoquerise do te permabajne adresen e pote te saj, numrin e regjistrimit ne Regjistrin QKR, si dhe Numrin e Regjistrit ne Organin tatimor te njesise ku do te ushtroje veprimtarine e saj.
- Per cestje te tilla qe nuk parashikohen ne Statut, veprimtaria e shoquerise do te bazohet ne legjisacionin perkates ne fuqi ne republiken e Shqiperise.

NENI 17 **HYRJA NE FUQI**

- Ky Statut i perpiluar nga une ortaku i vetem i saj ne kater kopje te barabarta hyn ne fuqi qysh ne mementin e nenshkrimit nga ana ime ne QKR Fier, ku depozitohet edhe kopja e pare.
- Ne rastet e likujdimit perfundimtare te shoquerise, sipas legjisacionit ne fuqi pushon se vepruari dhe ky Statut i saj.
- Krahas persosjes se metejshme te legjisacionit tregetar si dhe te ecurise se veprimtarise se shoquerise, une Ortaku i vetem i saj kam te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij Statusi, dhe te te gjithe dokumentave te Shoquerise duke bere depozitimet perkatese sipas legjisacionit ne fuqi.

**Statuti i mesiperm u nenshkrua nga une ortaku i vetem i shoquerise sot me date 23 Tetor
2019**

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Brikela BEJKO

